

URDHËR
Nr. 113, datë 26.3.2024

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, ZNJ. ANA KAPAJ**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj, për ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe nënshkruan akte për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

c) Inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve;

ç) Monitoron dhe organizon punën për zbatimin e strategjive kombëtare për arsimin në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, dhe nënshkruan akte që lidhen me to përfshirë programet dhe planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe planet e veprimit të tyre, në zbatim të legjislationit në fuqi;

d) Trajton dhe miraton standarde dhe kriterë të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

dh) Siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

e) Ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale;

ë) Trajton dhe nënshkruan programet e financimit dhe investimeve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin, si dhe ndjek dhe monitoron ecurinë e zbatimit të tyre;

f) Nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të MAS-së apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre;

g) Trajton dhe nënshkruan aktet për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të institucioneve të arsimit të lartë për të gjitha ciklet e studimit, certifikimin e kapaciteteve pritëse dhe rialokimin e kuotave të miratuara brenda njësisë kryesore;

gj) Trajton dhe miraton statutet dhe ndryshimet statutore të institucioneve të arsimit të lartë;

h) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

i) Ndjek dhe monitoron performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, me fokus strukturat AKFAL, AKKSHI, QSHA, ASCAL dhe institucionet e tjera që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

j) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron projektet strategjike dhe programet e studimit të të gjitha cikleve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke bashkërenduar punën me ministritë e tjera dhe të gjitha institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare;

k) Drejton grupe pune, në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicion përmirësimit të tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendas dhe të huaj;

l) Nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualet operationale tip, për punën e institucioneve të varësisë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

ll) Trajton dhe nënshkruan shkresat që i drejtohen institucioneve të tjera për çështje të antikorrupsionit dhe bashkëqeverisjes, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

m) Ndjek monitoron dhe nënshkruan, projektraportet dhe raportet e kontrollit të ligjshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë;

n) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit të lartë;

nj) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm;

o) Trajton dhe nënshkruan miratimin e vendimit të arsyetuar për vlerësimin e kontributit të shtetasve të huaj që kërkojnë fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit të lartë ose shkencës, nëse ai përbën interes për shtetin shqiptar ose jo, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe dhënien e pëlqimit nga ministria përgjegjëse për arsimin për titullin “Doctor Honoris Causa”, sipas kërkesave të institucioneve të arsimit të lartë, pas procedurave të verifikimit;

p) Përfaqëson ministrinë në këshilla vendas apo të huaj, grupe pune ndërinstitutionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera;

q) Përfaqëson institucionin në grupe pune lidhur me fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave arsimore në vend;

r) Bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat për çështjet e arsimit parauniversitar dhe sportit, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave;

rr) Informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të ministrit;

s) Ndjek procedurat ngarkuara ose autorizuara nga ministri bazuar në legjislacionin në fuqi;

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Ana Kapaj, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu